



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



KOMUNA E PRIZRENIT
OPSTINA PRIZREN
PRIZREN BELEDIYESI
MUNICIPALITY OF PRIZREN

01 Nr. 200/25 Dt. 24.03.2025



AGJENCIA PËR ZHVILLIM RAJONAL - JUG
REGIONALNA RAZVOJNA AGENCIJA - JUG
BÖLGESEL KALKINMA AJANSI - GÜNEY
REGIONAL DEVELOPMENT AGENCY - SOUTH

ANEKS MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet:

Komuna e Prizrenit

dhe

OJQ “Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug”

(AZHR Jug)

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit Nr.01/011-5643 i datës 15.10.2008, Marrëveshjes për Bashkëpunim Ndër komunal në Zonën Ekonomike "Jug" të datës 16 dhjetor 2008 nga kryetarët e gjashtë komunave të rajonit ekonomik jug, me ç'rast është themeluar Agjencia për Zhvillim Rajonal (AZHR) Jug, e cila ka të përcaktuar rolin e saj në zhvillimin socio-ekonomik të balancuar për rajonin tonë (aneksi 1), dhe Koncept Projektit të datës 07.03.2025 (aneksi 2) për zbatimin e projektit "Fuqizimi i të Rinjve të Prizrenit Përmes IA-së";

Duke u nisur nga interesi i përbashkët për të koordinuar aktivitetet e ndërlidhura për zhvillimin e qëndrueshëm socio ekonomik regjionale në komunën e Prizrenit përmes zhvillimit të sektorit privat dhe ngritjes së kapaciteteve lokale për të hartuar projekte;

Duke marrë parasysh përvojën dhe ekspertizën e deritashme të AZHR Jug në hartimin, dizajnimin dhe zbatimin e projekteve;

Komuna e Prizrenit e përfaqësuar nga kryetari i komunës z. Shaqir Totaj, me adresë "Adem Jashari" pn. 20000, Prizren dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal – Jug, me numër regjistrimi 51121783 dhe numër fiskal 600384945 të cilën e përfaqëson z. Nderim Bytyqi, drejtor, me adresë rr. "Marin Barleti" pn. 20000, Prizren, lidhim këtë Aneks-Memorandum Bashkëpunimi sipas dispozitave si në vijim:

Neni 1

Qëllimi i Aneks-memorandumit

Palët me vullnet të plotë pajtohen përmes këtij Aneks-memorandum bashkëpunimi që të zbatojnë projektin në fjalë, me ç'rast do të krijohen vende të reja të punës në komunën e Prizrenit, si dhe do të rriten kapaciteteve njerëzore lokale të komunës së Prizrenit.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Komuna e Prizrenit dhe AZHR Jug pajtohen të bashkëpunojnë si në vijim:

- 2.1 – Të zbatojnë projektin "Fuqizimi i të Rinjve të Prizrenit Përmes IA-së"
- 2.4 – Të punojnë në frymën e bashkëpunimit të ndërsjellë.
- 2.5 – Të sigurojnë përkrahje institucionale këtij Aneks-Memorandumit të Bashkëpunimit.

2.6 – Të përfaqësohen të barabartë para publikut.

2.7 – Të caktojnë anëtarët e grupit punues për këtë Aneks-Memorandum Bashkëpunimi

Neni 3

Obligimet e palëve

3.1 – Komuna e Prizrenit, respektivisht përfaqësuesi i saj i autorizuar/drejtoria përkatëse në bashkëpunim me AZHR Jug punojnë në hartimin, dizajnimin, përgatitjen, vlerësimin dhe monitorimin e aktiviteteve në kuadër të këtij Aneks-memorandumi.

3.2 – Komuna e Prizrenit financon projektin në vlerë prej 28,980.00 Euro

3.3 – AZHR Jug udhëheq dhe zhvillon procedurat financiare, si dhe organizon dhe mban aktivitete operacionale (takimet punuese të grupit punues për hartimin, vlerësimin dhe monitorimin).

3.4 – AZHR Jug bashkefinancon me para dhe në natyrë në vlerë prej 3,640.00 Euro këtë MiB.

Neni 4

Kohëzgjatja e këtij Memorandumi të Bashkëpunimit

4.1 – Ky Aneks-Memorandum Bashkëpunimi vlen prej datës 1 prill – 31 dhjetor 2025.

4.2 – Ky Aneks-Memorandum Bashkëpunimi ka mundësi vazhdimi edhe për një vit, në rast se palët pajtohen të vazhdojnë bashkëpunimin.

Neni 5

Pëlqimi i palëve

5.1 – Palët do të veprojnë me besueshmëri dhe kredibilitet të plotë në përmbushjen e qëllimi të këtij Aneks-Memorandumi të Bashkëpunimit.

5.2 – Në rast të ndonjë mospajtimi ose dileme, palët pajtohen të zgjidhin çështjet kontestuese në mënyrë miqësore, me marrëveshje konsensuale.

Neni 6

Nënshkrimi

6.1 – Ky Aneks Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet me datë _____.

6.2 – Ky Aneks-Memorandum Bashkëpunimi ka katër (4) kopje, nga dy për secilën palë.

Komuna e Prizrenit

z. Shaqir Totaj

Kryetar



AZHR Jug

z. Nderim Bytyqi

Drejtore

Pjesa financiare e këtij MOU është e paraqitur si më poshtë:

Ndarja e buxhetit:

Kategoria	Njësia	Sasia	Vlera	Shuma	Donatori
Programi Fuqizimi i të Rinjve të Prizrenit Përmes IA-së	1	1		28,980.00 €	Komuna e Prizrenit
Materialet e trajnimit	Person	105	20 €	2,100 €	AZhR
Qiraja e sallës	Muaj	7	200 €	1,400 €	AZhR
Interneti	Muaj	7	20 €	140 €	AZhR
Totali				32,620 €	